



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

---

Prishtinë, 15 tetor 2010  
Ref. Nr.: RK 52/10

**VENDIM PËR PAPANUESHMËRI**

në

Rasti Nr. KI 28/09

Ilaz Çerkinaj

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Në përbërje të

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, Gjyqtar  
Altay Suroy, Gjyqtar  
Almiro Rodrigues, Gjyqtar  
Snezhana Botusharova, Gjyqtare  
Ivan Čukalović, Gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, Gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, Gjyqtar

**Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Ilaz Çerkinaj, avokat nga Prishtina.

**Objekti i çështjes**

2. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtutjeshëm: "Gjykata") që ta interpretojë nenin 111 [Avokatura] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

### **Baza juridike**

3. Neni 113 (7) i Kushtetutës, nenet 22 (7) dhe (8) të Ligjit (No. 03L-121) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i miratuar më 16 dhjetor 2008, , (në tekstin e mëtuftjeshëm: "Ligji") dhe neni 54 (b) i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtuftjeshëm: "Rregullorja e punës").

### **Procedura para Gjykatës**

4. Më 10 dhjetor 2009, Parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar Kërkesë pranë Gjykatës.
5. Më 8 prill 2010, Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga Gjyqtarët Ivan Ćukalovič (Kryesues), Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj, shqyrtoi Raportin e Gjyqtarit Raportues, Iliriana Islami, dhe ofroi rekomandim për Gjykatën e plotë lidhur me papranueshmërinë e Kërkesës.

### **Pohimet e Parashtruesit të kërkesës**

6. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata interpretimin e nenit 111 të Kushtetutës, duke pretenduar se Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve, e cila është pjesë e Ministrisë së ekonomisë dhe tregtisë së Republikës së Kosovës, regjistron bizneset e avokatëve të cilët nuk janë të regjistruar në Odën e Avokatëve.
7. Sipas Parashtruesit të kërkesës, kjo mundësi shfrytëzohet nga ata që e kanë të ndaluar praktikimin e profesionit të avokatit për shkak të sjelljeve të dobëta profesionale. Në vend të kësaj, ata regjistrohen si biznes për të vazhduar praktikimin e profesionit.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës**

8. Për ta gjykuar Kërkesën e parashtruesit, së pari duhet shqyrtuar nëse parashtruesi i ka përmbushur kërkesat për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë dhe më tutje të specifikuar në Ligj dhe Rregullore të punës.
9. Është e qartë nga dokumentet e dorëzuara se Parashtruesi i kërkesës nuk ka *locus standi*, para kësaj Gjykate sepse ai nuk ka vërtetuar se një autoritet publik ka shkelur ndonjë të drejtë dhe liri të tij individuale të garantuar me Kushtetutë, sikurse kërkohet me nenin 113 (7) të Kushtetutës.
10. Parashtruesi i kërkesës thjeshtë kërkon një interpretim të nenit 111 të Kushtetutës.
11. Në këto rrethana, Gjykata vjen në përfundim se Kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, njëzëri merr

### VENDIM

- I. PËR TA REFUZUAR Kërkesën si të Papranueshme.
- II. Në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit, ky Vendim do t'i komunikohet Palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari Raportues**

Dr. Iliriana Islami

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. Dr. Enver Hasani

